



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË MALLAKASTËR

Nr. 2696/3 Regj.

Ballsh, më 29 / 12 /2017

VENDIM

Nr. 64 datë 25 / 12 /2017

“PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE DHE  
INSTITUCIONEVE NË VARTËSI, STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIN E  
PAGAVE NË BASHKINË MALLAKASTËR PER VITIN 2018”

**KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR**

Në bazë të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 115/2014 “Për Ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes Vendore”, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar me Ligjin 178/2014, VKM Nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve adminastrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, si dhe projekt-vendimit nr.12, datë 19.12.2017, në mbledhjen e datës 25.12.2017 Këshilli Bashkisë Mallakastër :

**VENDOSI:**

1. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në vartësi për vitin 2018 si më poshtë dhe sipas tabelës nr 1 pjesë përbërëse e këtij vendimi

1.1 Numri i punonjësve gjithsej nga të cilët	434
1.2 Punonjës të administratës dhe të shërbimeve publike në Bashkinë Mallakastër	304
1.3 Funksione të transferuara (paga e të cilëve vijnë me transfertë specifike)	123





<i>1.3-1 Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri</i>	15
<i>1.3-2 Funksione të transferuara nga Arsimi (kopshte, QKF, punonjës shërbimesh te arsimit)</i>	101
<i>1.3-3 Specialist pyjesh (transferuar nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mallakastër)</i>	4
<i>1.3-4 Specialist i bujqësisë (transferuar nga ish-Bordi i Kullimit Fier)</i>	3
<b>1.4 Funksione të deleguara</b>	<b>7</b>
<i>1.4-1 Punonjës të funksioneve të deleguara (të gjendjes civile)</i>	7

2. Të miratojë strukturën organizative dhe nivelin e pagave në Bashkinë Mallakastër për vitin 2018.

Bashkëngjitur gjendet tabela e strukturës organizative dhe nivelit të pagave për vitin 2018.

2.1. Efektet financiare fillojnë nga 01.01.2018

SEKRETAR

Fatjon NAZËRAJ



KRYETAR

Migjen SKËNDERAJ